



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-22-0700-A0001

Në ankesën e

Paditësja

Sh Q nga Prizreni , i përfaqësuar nga avokati **B I** Prishtinë.

Kundër

E paditura/Ankuesja

NSH "Komuna" (në likuidim), Prizren, të cilën e përfaqëson, **Agjencia Kosovare e Privatizimit,** Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe, Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-7236 të datës 06 dhjetor 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 28 mars 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, C-IV-14-7236 i datës 06 dhjetor 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Në vitin 2013, pranë DHPGJS përfaqësuesi i paditëses ka parashtruar ankesë kolektive për grupin e punëtoreve kundër të paditurës, në lidhje me Vendimet e Autoritetit të Likuidimit (AL) për NSH "Komuna" me të cilat janë refuzuar kërkesat për kompensimin e pagave të pa paguara. Rasti ishte regjistruar si C-IV.-13-2716, por që DHPGJS me urdhrin, C-IV.-13-2716, datë 28 tetor 2014, kishte urdhëruar përfaqësuesin e paditëses që të paraqes ankesë të veçantë për secilin paditës. Me 27 nëntor 2014, përfaqësuesi i paditëses ka paraqitur ankesë të veçantë për paditësen dhe lënda është regjistruar me shenjen, si C-IV.-14-7236. Më ankesë dhe me parashtrësën e dt. 27 prill 2021, paditësja nëpërmjet përfaqësuesit ka kundërshtuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit (AL) PRZ035-0180/88, të datës 30 shtator 2013, me të cilin është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e paditëses për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën janar 2004 deri në dhjetor të vitit 2005, në shumën prej 2,175.00 euro, me arsyetim se kërkesa është parashkruar nën 608 të Ligjit për Punë të Bashkuar. Paditësja i kundërshton këto konstatime të Autoritetit të Likuidimit duke i konsideruar si jo të drejta. Paditësja pretendon se në rastin e saj nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike, dhe rrjedhimisht gabimisht është zbatuar edhe e drejta materiale. Paditësja thekson se ka punuar tek e paditura prej datës 01 nëntor 1982 deri më 27 mars 2007, kur të njëjtës ju është ndërprerë marrëdhënia e punës nga ana e AKM-së dhe se ka pranuar njoftimin i cili e ka ndërprerë rrjedhën e parashkrimit, andaj nuk mund të bëhet fjalë për parashkrim të kërkesës. I ka propozuar Gjykatës që ta aprovoj ankesën e saj si të bazuar dhe t'ia njoh shpenzimet e procedurës. Bashkë me ankesë paditësja ka dorëzuar, Autorizimin për përfaqësim, Vendimin e AL PRZ035-0180/88, të datës 30 shtator 2013, Njoftimin për fillimin e procedurës së likuidimit i lëshuar nga AKM-ja si dhe Njoftimin për Ndërprerje të Marrëdhënies së punës të datës 27 mars 2007, po ashtu edhe listën e pagave për vitin 2004 dhe 2005 si dhe Kopjen e Librezës së Punës.

Me 23 gusht 2022, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. AKP-ja është deklaruar se NSH "Komuna" ka hyrë në procedurë të likuidimit më 06 mars

2008, ndërsa paditësja ka ushtruar kërkesë kreditore duke kërkuar kompensimin për paga të pa paguara për periudhën janar 2004 deri në dhjetor të vitit 2005, në shumën 2,175.00 euro. AKP-ja ka pohuar se paditësja ka dështuar të theksoj në ankesë se cila dispozitë ligjore e Ligjit të AKP-së është shkelur me vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit. Tutje AKP-ja pohon se pagat e kërkuara nga paditësi nga muaji janar 2004 e deri në dhjetor 2005 janë të parashkruara, pasi që ai nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi me të cilën do të dëshmonte se i ka kërkuar këto paga para ndonjë Gjykate apo organi tjetër kompetent në afatin prej tri viteve. Andaj me të drejtë Autoriteti i Likuidimit kërkesën e ka refuzuar si të pa vlefshme pasi që ajo ishte parashkruar.

Me 06 dhjetor 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-14-7236 e aprovon ankesën e paditëses si të bazuar, e ndryshon Vendimin e Autoritetit të Likuidimit për NSH "Komuna", PRZ035-0180/88, të datës 30 shtator 2013, dhe obligon të paditurën që paditëses Sh Q për paga të pa paguara për periudhën 01.01.2004 deri më 31 dhjetor 2005, t'ia paguajë shumën 2,175.00 euro, si dhe për shpenzime të procedurës në shumën 125.00 euro, sipas nenit 40.1.1.7, të Shtojcës së Ligjit për AKP-në nr.04/L034. Shkalla e I-rë e DHPGJS ka arsyetuar se nuk është kontestues fakti se paditësja ishte një punëtore e NSH "Komuna" në Prizren, dhe se kjo është dëshmuar me provën e listës së pagave të pa paguara për Punëtorët e NSH-së "Komuna" për periudhën e vitit 2004 dhe vitit 2005, ku vërtetohet se paditësja ishte në listën e pagave me numër rendor 88 dhe për vitin 2004, ju janë llogaritur pagat e pa paguara në shumën 1,358.43 euro ndërsa për vitin 2005 ju janë llogaritur pagat në shumë 921.09 euro. Shkalla e I-rë kishte konstatuar se njoftimi i AKM-së i datës 27 mars 2007 për paditësen me të cilin ka përfunduar punësimi për shkak se shitjes së aseteve të ndërmarrjes, ka prodhuar efekt juridik si për paditësen si për punëtor ashtu edhe për ndërmarrjen, si punëdhënës sa i përket të drejtave dhe obligimeve të krijuara nga marrëdhënia e punës deri më 27 mars 2007. Ky njoftim kishte prodhuar efekt juridik edhe në lidhje me borxhet/pagat e pa paguara deri në ditën e lëshimit të tij, si për paditësen ashtu edhe për të paditurën. Shkalla e I-rë kishte konstatuar se periudha janar 2004 deri në dhjetor 2005 nuk është parashkruar është arsye se

paditësja si provë materiale ka bashkangjitur Letër Pezullimin e cila në kuptim të nenit 387 të LMD-së, nënkupton se parashkrimi është ndërprerë dhe ka filluar të rrjedhë afati i ri i parashkrimit. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se paditëses nuk i është parashkruar kërkesa saj kreditore dhe se të njëjtës ju njihet e drejta për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën e muajit 1 janar 2004 deri në muajin 31 dhjetor të vitit 2005, në shumën prej 2.175,00 euro si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore prej 125,00 euro, të cilat shuma do të paguhen në procedurën e likuidimit sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj.

Me 27 dhjetor 2022, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-14-7236 të datës 06 dhjetor 2022, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit, të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditëses dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. AKP-ja në ankesën e parashtruar thekson se Shkalla e I-rë në rastin konkret ka konstatuar se paditësja kishte dorëzuar një kërkesë brenda afateve pranë AL më 12 maj 2008 dhe me këtë veprim e ka ndërprerë afatin e parashkrimit për 3 vite para, që i bie se me këtë veprim paditësja e ka ndërprerë afatin e parashkrimit deri në Qershor të vitit 2005. Për më tepër në ankesë AKP-ja pohon se Gjykata e Shkallës së I-rë është tërësisht jashtë kontestit faktik të çështjes. Autoriteti i Likuidimit thekson se janë dy afate të ndryshme, ai për parashtrimin e ankesave që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurën e Likuidimit dhe afati i dytë ka të bëjë me natyrën (meritat e të drejtës) që referohet parashkrimit të kërkesës në afatin prej 3 viteve. Tutje AKP-ja pohon se njoftimi i AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës së cilës i referohet Gjykata e njofton paditësen për të drejtën që të parashtrrojë kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit, ky njoftim nuk i mbron të drejtat dhe as nuk jep mjete ligjore për paditëses. Tutje AKP-ja ende konsideron se kërkesa për paga të pretenduara nga paditësja janë parashkruara në bazë të Nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar pasi që paditësja nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi të ketë kërkuara këto paga brenda 3 viteve.

Me 21 dhjetor 2023, paditësja e dorëzoi një parashtrësë në DHPGJS dhe përgjigjet në ankesën e AKP-së. Në këtë parashtrësë paditësja i kundërshton pretendimet ankimore të AKP-së dhe e mbështetë Aktgjykimin e ankimuar të Shkallës së I-rë si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Tutje paditësja pohon se AKP-ja vetëm i ka përsëritë pretendimet e veta të mëhershme dhe nuk ka paraqitë ndonjë fakt apo provë që do ta kundërshtonte gjendjen e vërtetuar drejtë faktike nga Shkalla e I-rë. Tutje paditësja pretendon se janë të gabuara pretendimet e AKP-së për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike apo aplikim të gabuar të së drejtës materiale. Në këtë parashtrësë paditësja ka kërkuar që të refuzohet ankesa e AKP-së, të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë dhe detyrohet AKP-ja të paguaj shpenzimet e përfaqësimit prej 208 euro.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetim ligjorë, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësja ka paraqitur një kërkesë në AKP për kompensim të pagave të pa paguara për periudhën janar 2004 deri në dhjetor 2005. Kërkesa e paditëses për paga ishte në shumë prej 2,175.00 euro. Kjo kërkesë ishte refuzuar si e pa vlefshme me arsyetimin se ajo është parashkruar në bazë të Nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Këtë konstatim të gabuar të Autoritetit të Likuidimit nuk e ka mbështetur Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me rastin e shqyrtimit

të ankesës të paraqitur nga paditësja kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRZ035-0180/88 të datës 30 shtator 2013.

Shkalla e I-rë ka konstatuar se paditëses i është ndërprerë marrëdhënia e punës, me datë 27 mars 2007, me njoftimin e dërguar nga ish AKM-ja, dhe se ky njoftim e kishte ndërprerë rrjedhën e parashkrimit të kërkesës. Shkalla e I-rë e DHPGJS ka arsyetuar se nuk është kontestues fakti se paditësja ishte një punëtore e NSH "Komuna" në Prizren, sepse nga Libreza e punës e dorëzuar si provë vërtetohet fakti se ankuesi kishte krijuar marrëdhënie pune me NSH "Komuna". Tutje Shkalla e I-rë konstaton se paditësja nuk i është parashkruar kërkesa saj kreditore dhe se të njëjtës ju njihet e drejta për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën janar 2004 deri në dhjetor të vitit 2005, në shumën prej 2,175,00 euro, si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore prej 125,00 euro, të cilat duhet të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Kolegji i Apelit i mbështet këto konstatime dhe gjetje faktike të Shkallës së I-rë, duke konsideruar se kërkesa për pagat për periudhën 1 janar 2004 deri në 31 dhjetor 2005, nuk janë parashkruar, andaj ishte i gabuar konstatimi i Autoritetit të Likuidimit se kërkesa është e parashkruar.

Kolegji i Apelit konstaton se është i drejtë konstatimi i Shkallës së I-rë se Njoftimi i AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës e ka ndërprerë rrjedhën e parashkrimit dhe ky qëndrim ligjor tashmë është shprehur në shumë raste të mbyllura në jurisprudencën e deri tanishme të Kolegjit të Apelit.

Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit konstaton se me të drejtë Shkalla e I-rë e kishte ndryshuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, pasi që ai vendim nuk ishte i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Prandaj nga këto arsye, ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar, dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, në shumë prej 100 euro, me datë 23 janar 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 28 mars 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
